



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr.Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për klasat e shansit të dytë)

LËNDA: EDUKIM FIGURATIV

KLASA I-V

Tiranë

Dhjetor 2013

Edukimi figurativ është një pjesë e rëndësishme e përgatitjes së ardhshme të nxënësit, luan rol të rëndësishëm në shprehjen e emocioneve, të jetës shpirtërore, kulturore, shoqërore dhe zhvillimit intelektual të njeriut. Si i tillë ai ka marrë sot vendin e merituar në programin mësimor të arsimit të detyruar. Edukimi figurativ vlerësohet si një nga mënyrat më të frytshme për edukimin estetik dhe zhvillimin mendor të fëmijës, për vetë faktin e ndërtimit specifik të trurit të njeriut dhe aq më tepër të karakteristikave mendore të fëmijëve, si dhe të lidhjeve të ngushta që ka me të shkruarit e lëndë të tjera në shkollë.

Programi i edukimit figurativ në sistemin e ri arsimor, sjell në përmbajtjen e tij përvojën më të mirë të një programi arti të studiuar nga ana psikologjike dhe artistike në përputhje me moshën. Programi realizon atë që duhet të njohin dhe të bëjnë nxënësit në edukimin figurativ. Ai ka në qendër përvojën e nxënësit, të cilën kërkon ta njohë, ta zhvillojë, ta pasurojë e ta çojë më përpara, duke e ndërthurur atë në mënyrë të natyrshme me historinë, kulturën, artin jo vetëm të mjedisit ku jeton e mëson fëmija, por me atë të krahinave të tjera të atdheut të tij e të vendeve të ndryshme të botës, që ai ta ndjejë veten pjesë të së tërës, të botës ku jeton.

Të përgatitësh fëmijët për të ardhmen, duhet që t'i edukosh ata në mënyrë të tillë që jo vetëm të kuptojnë botën që na rrethon, por të japin edhe ndihmesën e tyre. Ata duhet të dinë të bëjnë më shumë, të dinë si të përvetësojnë çdo ndryshim të teknologjisë dhe të shkëmbimit të informacionit. Sot në botë ka më shumë informacion se mund të shprehin fjalët dhe numrat, e kjo gjen pasqyrim në edukimin figurativ e programin që u paraqesim për të punuar me nxënësit. Ky program e ndihmon nxënësin të zhvillojë aftësitë e tij për të qenë sa më i suksesshëm në jetë.

SYNIMI I LËNDËS

Programi i edukimit figurativ ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit për të kuptuar artin figurativ duke u shprehur nëpërmjet tij.

Objektivat

Mësimi i edukimit figurativ ka për qëllim që nxënësit në fund të klasës së pestë:

- Të krijojnë punë të ndryshme arti, në 2-3 përmasa, që komunikojnë ide, mendime, ndjenja, përvoja, për një qëllim të caktuar;

- Të përdorin elementet dhe parimet e artit (ngjyrat, vijat, formën, hapësirën, sipërfaqet) në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel;
- Të përshkruajnë si elemente të ndryshme të artit (të ndeshura në vepra arti) lidhen me njohuritë dhe përvojat e veta;
- Të përdorin një fjalor dhe terminologji artistike, të thjeshtë për këtë nivel.

LINJAT E PROGRAMIT

Programi i Edukimit figurativ, për klasat e Shansit të Dytë, arsimit fillor është i organizuar në bazë të 6 linjave të cilat zërthehen si më poshtë:

1. Baza materiale, procese, teknika
2. Parime dhe elemente
3. Tematika
4. Historia dhe kultura
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi
6. Lidhjet ndërlëndore me jetën

METODOLOGJIA

Në qendër të metodologjisë së programi të edukimit figurativ është përvoja e nxënësit, të cilën e formon, e përmirëson dhe e edukon atë vazhdimisht. Meqenëse veprimtaria bazë e nxënësit të kësaj moshe është loja, edhe programi realizohet nëpërmjet lojës. E pasuruar me imagjinatën e fantazinë e nxënësit, krijohet një atmosferë e cila sjell kënaqësinë në veprimtarinë e tij. Këto dy elemente, **loja dhe kënaqësia**, janë shumë të rëndësishëm për realizimin e suksesshëm të programit. Programi i edukimit figurativ është i ndërthuar mbi parime të përcaktuara për programet, në përgjithësi, por si program arti, ai ka veçoritë e tij.

- Rruajtja e **raportit mes njohurive e veprimtarisë praktike**. Temat e programit janë shtjelluar në mënyrë të tillë që çdo njohuri e marrë, të zbatohet në praktikë në një ose dy orë mësimi, sipas përvojës së nxënësit dhe shkallës së vështirësisë së konceptit.
- **Dhënia e njohurive në formën e rrrathëve bashkëqendrorë**, d.m.th. që njohuritë dhe aftësitë e marra në një mësim, rimerren në një mësim tjetër. Koncepti për llojet e vijave i dhënë në një mësim, përforcohet në mësimet e tjera, si: te portreti, peisazhi,

ilustrimet. Po kështu, mund të japim shembull edhe me dhënien e konceptit për ngjyrat bazë, për ngjyrat e ngrohta e të ftohta, për tonalitetet e ngjyrave etj.

- **Zhvillimi i koncepteve, njohurive, aftësive e shprehive në bazë të zhvillimit psikologjiktë përshkallëzua të fëmijës.** Këtu për t'u përmendur janë njohja e përshkallëzuar me konceptin e ngjyrës, ku nxënësi fillon të përdorë ngjyrat jo më rastësisht, të perspektivës, mënyra e vendosjes së figurave afër-larg, njohja me vijën e horizontit. Shumë domethënëse është punimi me plastelinë për të dhënë dallimet mes figurave dhe trupave (figura është me 2 përmasa, trupat janë me tri përmasat).
- **Kalimi i vijës metodologjike të krijimtarisë artistike të nxënësit nga vëzhgimi në natyrë në mjedisin rrethues etj.,** në ilustrimin apo diskutimin e tyre në mënyrë të përshtatshme dhe të kuptueshme për këtë nivel, nën drejtimin e mësuesit (shpjegimi i temës dhe mënyrat e realizimit të saj). Kjo vijë kalon edhe në veprimtarinë e pavarur të nxënësit, kur ata në krijimet e tyre, përdorin elementet dhe parimet që mësojnë, duke përdorur teknikat e përshtatshme, si dhe në vlerësimin artistik që i bëjnë punës së tyre apo të shokut.
- **Liria individuale në krijimtari** është karakteristikë e rëndësishme e programit. Kjo do të thotë që nxënësi është i lirë të krijojë në variantin që i pëlqen, duke iu përmbajtur temës së caktuar.
- **Përvojat vetjake** të nxënësve janë shumë e rëndësishme që mësuesi të marrë parasysh, duke i nxitur, disiplinuar dhe plotësuar ato. E rëndësishme është edhe **puna në grup**, si: mbledhja e materialeve ilustruese, diskutimet e hapura në klasë dhe realizimi i krijimeve të përbashkëta.
- Tematika e programit krijon hapësira për të zgjedhur temat që të jenë sa më **afër jetës e veprimtarisë së nxënësit.**

UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në standardet e arritjes, një dokument të cilin mësuesit duhet ta kenë gjithmonë pranë për të qenë sa më i qartë e i saktë në vlerësim. Metodologjia për të vlerësuar nxënësit në lëndën “Edukim figurativ” nuk do të bazohet në konkurrencë, por në bazë të një diskutimi të natyrshëm për arritjet dhe ato që nxënësit duhet të realizojnë më mirë në veprimtarinë praktike e krijuese. Në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit dhe zakonisht bëhet në fund të orës së mësimit. Vlerësimi nuk do të

thotë që të bëhet çdo orë, por e rëndësishme është që mësuesit të reagojnë gjithmonë gjatë veprimtarisë së nxënësit. Vlerësimi bëhet për grup-temash për të gjithë nxënësit, apo dhe në mënyrë individuale sipas kritereve që mund të vendosë shkolla.

Vlerësimi është një moment i rëndësishëm në të cilin ka patur debate për të arritur saktësi. Standardet e arritjes i orientojnë mësuesit si të mbështeten në krijimet dhe interpretimet e nxënësve për të përcaktuar saktë vlerësimin e tyre. Mënyrat për të arritur në saktësi, janë të shumta .

Mësuesi zgjedh mënyrën për të vlerësuar, si: vëzhgimin, pjesëmarrjen, interpretimin, shkallën e vështirësisë, kontrollin e dosjes së punimeve, vlerësimin e ekspozitave, vetëvlerësimin, origjinalitetin në krijim, përshkallëzimin në punë etj.

Vlerësimi mbështetet mbi parime, si:

- të vlerësojë krijimtarinë e nxënësit, jo imitimin e punës së shokut apo të figurave që paraqiten për ilustrim.
- të nxisë krijimin e dosjes së punimeve që është një dokumentacion, i cili krijon një sistemim të njohurive, prandaj mësuesi duhet ta kërkojë dhe në një kohë të përshtatshme e merr si dokument vlerësimi.
- të përdorin fjalorin artistik si një testim i njohurive artistike.
- të vlerësohet diskutimi, dhënia e ideve, lidhja e veprimtarisë jetësore me artin, p.sh., veshja e bukur, dekorimet në to e në mjediset e shkollës, ku secili nxënës shpreh shkallën e formimit të tij.

INTEGRIMI

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit do të kapin me lehtësi lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin. Kjo lëndë tregon se sa i lidhur është edukimi figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u siguruar mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke ndërthurur artin pamor me forma të tjera të artit. Kështu, për shembull, nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ, të kuptojë krijimin e ngjyrave përmes përbërësve kimikë. Mund të krijojë në kompjuter, duke përdorur elementet e edukimit figurativ dhe median elektronike etj.

MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi, shkolla mund të përdorë mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë :

Grupi i parë: shkumsa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë: vinovil, letërngjitëse, skoç, vizore, gërshërë.

Grupi i tretë: penela të ndryshme, të cilat janë të përcaktuar në paketa të veçanta (të jenë të disa madhësive), fletore vizatimi, fletore për punëdore, letër tabak, kartona me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akuarel.

Grupi i pestë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, peceta, gazeta (për mësuesin duhet të krijohet një bazë e fuqishme për ilustrim).

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e artit pamor, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë me një dritë të plotë, në një vend të sigurt, ku t'i mbështesë mjetet e tij, në një vend të ngrohët e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa si studio (kabineti i posaëëm i artit figurative). Në pamundësi, duhet që klasa të ketë kushtet e përshtatëshme.

KLASA I-rë

30 javë x 1 orë = 30 orë

1. Baza materiale, procese e teknika	3 orë
2. Elemente dhe parime	12 orë
3. Tematika	4 orë
4. Histori dhe kulturë	4 orë
5. Analiza, interpretimi , vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	4 orë

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

LINJA I. Baza materiale, proceset, teknikat **3 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përdorë shumëllojshmëri mjetesh e materialesh, si: lapsa, lapsa me ngjyra, penela, akuarelet, vinovilin, gërshtëren, letër për punëdore e letër vizatimi, tekstile, plastelinë;
- Të punojë në teknikën e kolazhit, instalacionit, sfungjerit e stampa të thjeshta;
- Të krijojë me ngjyrat bazë e të dyta;
- Të krijojë nuanca të çelura e të errëta;
- Të përdorë materiale me sipërfaqe të ndryshme;
- Të krijojnë skulpturën e një njeriu apo kafshe me plastelinë.

LINJA II. Elemente dhe parime **12 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të dallojë e të përdorë ngjyrat bazë dhe ngjyrat që krijohen nga përzierja e tyre (rrethi i ngjyrave);
- Të përcaktojë ngjyrat e ngrohta e të ftohta, duke krijuar me to;
- Të njohë llojet e vijave: e drejtë, e thyer, zigzag, e përkulur, e trashë, e hollë;
- Të shprehë lëvizjen nëpërmjet vijave;
- Të dallojë format e figurave: katrore, drejtëkëndësh, trekëndor, rrethor, ovale;

- Të përcaktojë ndryshimet mes formave gjeometrike e natyrore e duke krijuar me to;
- Të dallojë format e trupave e të bëjë dallimin nga figurat;
- Të përcaktojë llojin e sipërfaqeve, të krijojë koleksion ose një punim;
- Të njohë parimet e artit (unitetin, theksin, ritmin), ekuilibrin, lëvizjen, kontrastin, harmoninë) e t'i përdorë ato duke iu përshtatur këtij niveli;
- Të krijojë duke bërë dallimin hapësirë - tokë, vija e horizontit;
- Të japë idenë e perspektivës me anë të vendosjes së trupave afër- larg;
- Të krijojë nga ilustrime të thjeshta, si, p.sh., të një përralle, vjershe, tregimi, libri.

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përshkruajë e të përzgjedhë për të krijuar një veprimtari të jetës së tij, si: loja, mësimi, familja, festat etj.;
- Të përdorë simbole të ndryshme për të dhënë një ide: koleksion me pulla, vizatimi i Flamurit Kombëtar etj.;
- Të përdorë në shërbim të temës bazë të ndryshme materiale.

LINJA IV. Historia dhe kultura

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të identifikojë forma të artit shqiptar, si: karakteristikat e arkitekturës së ndërtesave, të veshjeve, të qëndisjeve, të zbukurimeve të mjediseve;
- Të vëzhgojë dhe të bisedojë rreth artit dhe kulturës së periudhëve të ndryshme, duke ilustruar me punime të autorëve të periudhave të ndryshme, si: vizatimet e gjetura në shpella, statuja ilire, busti i Skënderbeut;
- Të përcaktojë ngjashmëritë dhe ndryshimet e kulturës e artit të periudhave të ndryshme;
- Të dallojë atë që është artistike në arkitekturë e mjedisit, si: në shtëpitë e banimit, këndin e lojërave etj.

LINJA V. Analiza, interpretimi, vlerësimi **3 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të vëzhgojë e të diskutojë për forma të ndryshme të artit, duke paraqitur ilustrime të pikturave, skulpturave, ku nxënësi t'i përgjigjet pyetjes: “Çfarë shikon?”;
- Të diskutojë një vepër arti duke përdorur fjalët: tematika, ideja, ndjenjat;
- Të shpjegojë në punën e tij e të shokut si janë përdorur elementet e artit;
- Të krahasojë punimin e tij me të shokut dhe të bëjë dallimin mes tyre;
- Të paraqesë punimin e tij përpara klasës dhe të tregojë me fjalë të thjeshta teknikën, proceset, mjetet, që ka përdorur.

LINJA VI. Lidhja ndërlëndore dhe me mjedisin **4 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të diskutojë për rolin e artit në jetën e familjes dhe në jetën e tij të përditëshme;
- Të diskutojë për rolin e artit në festa, veshje, dekorime;
- Të bëjë dallimin si arti ndikon në jetën e tij emocionale;
- Të ballafaqojë lidhjet e artit me njohuritë që merr në lëndët e tjera.

KLASA II - të

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

$$30 \text{ javë} \times 1 \text{ orë} = 30 \text{ orë}$$

1. Baza materiale, procese e teknika	3 orë
2. Elemente dhe parime	14 orë
3. Tematika	4 orë
4. Historia dhe kultura	3 orë
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore me jetën	3 orë

LINJA I. Baza materiale, procese, teknika **3 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të përdorë materiale të ndryshme dhe të diskutojë efektet që realizojnë ato në një punim artistik;
- përdorimi i ngjyrave të dyta në materiale të ndryshme (*si letër, basme, karton, etj., - kolazh*);
- përcaktimi i efekteve të ndryshme, p.sh., shkumsat, tempera, akuarelet, lapustilat etj., që japin këto materiale, duke vepruar me ngjyrat e dyta;
- përshkrimi i tyre përdorimeve në një vepër arti të një artisti të caktuar për dhënien e një emocioni;
- përdorimi i mjeteve, si: shkumsat me ngjyra, lapsa, temperat, akuarelat, pastelat, furçat për të krijuar një vepër arti, në teknika të ndryshme;
- të përdorë teknikat:
 - *Krijim pikturë*: ngjyrosja me sungjer, sitë ose spraj, përzjerja e ngjyrave të para me të dytat;
 - *Vizatim*: perspektiva (vendosja e trupave afër – larg);
 - *Skulpturë*: krijimi i maskave, përdorimi i letrës për mbushje të objekteve artistik;
 - *Tekstil*: thurje sipas vijës së drejtë e të lakuar (qëndisje në thes me fill të trashë kuvaristo), zbatim me tekstile (peisazh);
 - *Stampime*: stampime me materiale rrethimore (lapsa, pirun).
 - *Dizenjo*: kolazh, gdhendje.
- të përdorë materiale: lapsa, pastela, shkumsa, akuarele, letër me ngjyra, letër vizatimi, kartone, letër e zakonshme, copa tekstili, fije të trashësive të ndryshme;
- të përdorë mjete të ndryshme, si: penela, enë për mbajtjen e ujit, gërshërë, gjilpërë etj.;

LINJA II. Elemente dhe parime

14 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- *Vijat*:
- të krijojë shumëllojshmëri vijash nga materiale të ndryshme, si: pena, peneli, lapsi, pastela, qymyri, shkumësi (e përkulur, e trashë, e hollë) – (*vizatimi i një peisazhi, diskutimi dhe vlerësimi i efekteve të vijave sipas llojit në përfundim të punimit*).
- *Format 2 përmasore*:

- të kuptojë format organike që gjenden në natyrë dhe format gjeometrike gjenden në format e krijuara nga njeriu – *(kolazh me forma gjeometrike dhe organike të prera)*.
 - *Format 3 përmasore:*
 - Format 3 përmasore kanë: gjatësi, gjerësi dhe lartësi;
 - trupat me 3 përmasa përmbajnë edhe figurat – *(krijimi i një trupi me 3 përmasa me letër, ndërtimi i një shtëpie)*.
 - *Sipërfaqet:*
 - të përcaktojë sipërfaqen e duhur në krijimin e një interesi të veçantë në art përmes dy mënyrave: a) duke e prekur, b) nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë;

(Krijimi i një sipërfaqeje, duke përdorur laps e letër ose ngjyra uji)

(Vizatim i lëkurës, gëzofit të një kafshe)

Vizitë në një punishte tekstilësh ose tezgjah artizanal;

 - *Ngjyrat:*
 - të krijojë me ngjyrat e ngrohta e të ftohta, për të shprehur një gjendje të caktuar shpirtërore;
 - të njohë harmonizimin e ngjyrave të para dhe përdorimin e tyre për të dhënë një pamje të caktuar të stinës – *(peisazh nga vjeshta, pranvera, etj)*.
 - *Hapësira:*
 - të përdorë mbivendosjes e objekteve për të krijuar një punim artistik – *(krijim – fëmijët në rresht)*.
 - *Barazpesha:*
 - të krijojë përmes barazpeshës psh: nga përdorimi i simetrisë; simetria gjendet në objektet natyrore dhe të krijuar nga njeriu – *(krijimi i simetrisë boshtore me forma me letra)*.
 - *Theksi:*
 - të vendosë në qendër të pikturës e objektit më të rëndësishëm;
 - të përcaktojë pikën më të rëndësishme në riprodhimin e një pikturë për shembull: ngjyrat, masa, forma.
 - *Lëvizja:*
 - të krijojë mbivendosjen me format - *(kompozimi me mbivendosje të thjeshta për të krijuar lëvizjen)*.

- *Kontrasti:*
- të kuptojë kontrastin në ndriçim, masa dhe ngjyra – *(krijim duke përdorur kontrastin e ngjyrave).*
- *Harmonia:*
- të përcaktojë ritmin në natyrë apo në vepër e artit nga përsëritja e një modeli - *(krijimi i një pune artistike ku të përsëritet një motiv i thjeshtë (qilime me motive popullor);*

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të krijojë një revistë sipas imagjinatës, shijeve dhe interesave të tij - *(në të mund të ngjiten foto, piktura, mesazhe të ndryshme të marra nga revistat, gazetat);*
- të përdorë simbolet për të paraqitur harta, planimetri - *(vizatimi i simboleve të thjeshta, të qarkullimit rrugor ose një hartë të thjeshtë të shkollës apo lagjes ku jetojnë);*
- të vëzhgojë dhe të diskutojë një vepër arti, ku artisti të jetë frymëzuar nga një ngjarje jetësore (“Dasma” nga Kolë Idromeno).

LINJA IV. Historia dhe kultura

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të përshkruajë një portret, duke përcaktuar ndryshimet në kohë, përshkrimi i materialeve, përshkrimi i modes në veshje, krehje, prakticiteti i veshjeve - *(krijim me veshje të ndryshme);*
- Të njohë kështjellat shqiptare nëpërmjet riprodhimeve e fotografive – *(krijim duke u bazuar në imazhin e këtyre kështjellave).*

LINJA V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të diskutojë në një punim llojet e vijave, karakteristikat e tyre sipas materialeve me të cilat janë vizatuar, fletë për idetë, emocionin që përcjellin ato në atë punim.
- të shpjegojë dhe mbron punën e tij në klasë;

- të krahasojë dy punime artistike të fushave të duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik për elementet e parimet e artit - (*pikturë dhe skulpturë*), *por që rajtojnë t njëjtën temë, p.sh., një bust të Skënderbeut dhe një portret të tij në pikturë*);

LINJA VI. Lidhja ndërlëndore me jetën dhe me mjedisin 3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të gjejë elementet e artit (vijat, ngjyrat, format) në një endje, qëndisje, në një pëlhurë tekstili etj., nga kutura të ndryshme (në qilimat shkodranë, kuksianë, korçarë etj.)
- të ilustrojë me vizatime i një përralle, vjershe apo tregimi sipas imagjinatës së tij;
- të krijojë një vizatim nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë.

KLASA III - të

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

$$30 \text{ javë} \times 1 \text{ orë} = 30 \text{ orë}$$

1. Baza materiale, procese e teknika	2 orë
2. Elemente dhe parime	14 orë
3. Tematika	4 orë
4. Histori dhe kulturë	4 orë
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	3 orë

LINJA I. Baza materiale, procese, teknika

2 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përdorë *materiale* të ndryshme dhe të njohë efektet që ato krijojnë: lapsa, pastela, shkumësa, akuarele, letër me ngjyra, letër vizatimi, kartona, letër e zakonshme, bojëra uji, tempera, furçën, plastelinën, materiale për gdhendje;
- të njohë dhe të përdorë *teknikat, si:* akuareli, tempera, stampimi, vizatimi, modelimi i baltës, gdhendia (në sapun), kolazhi, tekstili etj. Krijim-gdhendje në sapun; qëndisje.

LINJA II. Elemente dhe parime

14 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

Vijat

- Të krijojë iluzionin e formës ose të volumit nëpërmjet vijave. Përdorimi imagjnatës për të krijuar peisazhin e qytetit, duke përdorur llojet e vijave: *e përkulur, e trashë, e hollë.*

Format 2-përmasore

- Të përdorë në krijimet e tij më shumë se një lloj forme për të ndërtuar një objekt. - Krijimi i një maske.

Format 3 përmasore:

- Të krijojë iluzionin e formës 3-përmasore (volumin) mbi një sipërfaqe 2-përmasore (fleta e vizatimit). Vizatimi me dritë hije i një objekti të thjeshtë.

Sipërfaqja

- Të krijojë sipërfaqen nëpërmjet vijave të përsëritura, formave dhe hapësirave. Krijim përmes thurjes me leckë ose me fije etj.

Ngjyra

- Të njohë dhe të krijojë nuancat e ngjyrave: të ngrohta e të ftohta, duke i përzier me të bardhën e të zezën. Përdorimi i ngjyrave plotësuese: kuqe-jeshile, blu – portokalli, lejla - verdhë në një krijim.

Hapësira

- Të japë iluzionin e hapësirës në krijimet e tij, nëpërmjet mbivendosjes së figurave. Përdorimi i konceptit të planeve, plani I,II,III. Krijim- Pejsazh ose natyrë e qetë.

Barazpesha

- Të përdorë ngjyrat, vijat, format për të krijuar barazpeshën në krijimet e tij. Krijim i një maske

Theksi:

- Të përdorë ngjyrën për të tërhequr vëmendjen e shikuesit dhe për të theksuar objektin kryesor. Krijim: Kompozimi me kafshë (2 ose më shumë, duke përdorur ngjyrën për të theksuar njërin prej tyre), kolazh.

Lëvizja:

- Të krijojë lëvizjen nëpërmjet mbivendosjes së figurave dhe formave.

Krijim : Gara e vrapimit

Uniteti:

- Të krijojë unitetin nëpërmjet përdorimit të vlerave dhe intensitetit të ngjyrës.

Krijim: Kompozimi “Lëndina me lule”

Kontrasti:

- Të krijojë thellësinë në punimet 2-përmasore nëpërmjet kontrastit. Krijim: Kompozim ku nëpërmjet përmasave dhe ngjyrave të ndryshme të krijojë thellësinë.

Harmonia:

- Të krijojë harmoninë në një krijim duke përdorur ritmin (përsëritja e një elementi për të krijuar të tërën (ritmi); Krijim : Dekoracion me motiv të thjeshtë.

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përzgjedhë e të përdorë tema nga fusha të ndryshme, për të shprehur mendimet e veta ose për të përcjellë një mesazh.

Krijim: Temë e lire (teknika sipas dëshirës)

Krijim: Krijimi i një reviste ose gazetë sipas dëshirës

LINJA IV. Histori dhe kulturë

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të njohë artistë të ndryshëm dhe veprat e tyre (bisedë e ilustruar në klasë);

Krijim “Natyrë e qetë “ .

Bisedë e lirë për të njohur artin popullor në objektet e përdorimit të përditshëm si (veshjet, qylymat, enët etj)..

LINJA V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të njohë teknikat e ndryshme të përdorura në vepra të ndryshme arti, si dhe mjetet dhe materialet. Bisedë e ilustruar në klasë (pikturë në vaj, skulpturë, etj.)
- të diskutojë për punën e tij dhe të shokut, mënyrën se i kanë përdorur njohuritë e marra në punën e tyre.
- të krijojë një ekspozite vetjake ose e përbashkët.

LINJA VI. Lidhja ndërlëndore dhe me mjedisin 3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë rolin e artit në jetën e përditshme dhe në mjedisin ku jeton.
Veprimtari praktike: Si të rregullojmë në mënyrë estetike mjedisin ku jetojmë
- Të zbulojnë si njerëzit përdorin imagjinatën, ëndrrat dhe përvojat jetësore në krijimet e tyre artistike.
Krijim: Një ëndërr, një ngjyrë që u ka bërë përshtypje

KLASA IV

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

30 javë x 1 orë = 35 orë

1. Baza materiale, procese e teknika	2 orë
2. Elemente dhe parime	16 orë
3. Tematika	6 orë
4. Histori dhe kulturë	4 orë
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi	4 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	3 orë

LINJA I. Baza materiale, procese, teknika 2 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përdorë *materiale* të ndryshme duke njohur efektet që ato krijojnë: lapsa, pastela, shkumësa, akuarele, letër me ngjyra, letër vizatimi, kartonë, letër e zakonshme, bojëra uji, tempera, furça, plastelinë, materiale për gdhendje. (*P.sh: diskutim dhe demonstrim të mjeteve dhe materialeve në klasë*).
- Të njohë dhe të përdorë *teknikat*, si: akuareli, tempera, stampimi, vizatimi, modelimi i baltës (plastelina), gdhendja (në sapun), kolazhi, tekstili etj. (*P.sh: diskutim dhe demonstrim të teknikave në klasë*).

LINJA II. Elemente dhe parime

13 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përdorë vijat të ndryshme në një punim me 2-3 përmasa, për të dhënë idenë e sipërfaqes (*Vijat*). (*P.sh: Peizazh – modelon gjatë krijimit sipërfaqen nëpërmjet vijave*).
 - Të përdorë format për të krijuar hapësirat pozitive dhe negative (*Format me 2 dhe 3 përmasa, p.sh: Krijim -: “Dita e karnavaleve”, poster*).
 - Të përdorë sipërfaqe të ndryshme për të krijuar variacione në punën e tyre (*Sipërfaqja p.sh: Krijim - një objekt 3- përmasor, ku të përdoren 3 sipërfaqe të ndryshme*).
 - Të përdorin ngjyrat e errëta dhe të çelëta në punimet e veta, duke përdorur të paktën 3 nuanca (*Ngjyra p.sh: Krijim me akualet*).
 - Të krijohet ideja e thellësisë, duke përdorur mbivendosjen e trupave dhe perspektivën me një pikë (*Hapësira p.sh: peizazh - pamja e qytetit (ky punim mund të përdoret për të realizuar dhe konceptet të tjera*).
 - Të përdorë ngjyrat, vijat, format për të krijuar një punim me balancën asimetrike (*Baraspesha p.sh:Krijim i lirë*).
 - Të krijojë theksin në punën e tij, duke përdorur ngjyrat, vijat, format, masat (*Theksi p.sh:Klouni*).
 - Të përdorë përsëritjen e një forme të vetme në krijimin e tij, duke dhënë kështu idenë e lëvizjes (*Lëvizja*).
 - Të krijojë unitetin në një punim (*Uniteti p.sh:Krijimi, p.sh., shkruaj në mënyrë argëtuese “Gëzuar ditëlindjen!”*).
 - Të përdorë ngjyrat e errëta dhe të çelëta për krijuar kontrastin (*Kontrasti p.sh: Krijim: “Në plazh”*).
- Të përcaktojë ritmin në natyrë apo në një vepër arti, nga përsëritja e një modeli. (*Harmonia, p.sh: Krijim i një motivi të thjeshtë, për shembull, qilima me motive popullore*).

LINJA III. Tematika

5 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të diskutojë si artisti gjen motivimin e veprës së tij, duke u frymëzuar nga veprimtari të jetës, si: gëzimet, hidhërimet, luftërat, dasmat, këngët etj. (P.sh: Diskutim rreth pikturës, për shembull: Kol Idromeno “Dasma shkodrane”).
- Të krijojë sipas imagjinatës, shijeve dhe interesave të tij, (p.sh: Krijim - Një revistë ku në të mund të ngjiten foto, mesazhe të ndryshme të marra nga revistat, gazetat etj).
- Të përdorë simbolet për të paraqitur harta, planimetri, (për shembull: vizatimi i simboleve të thjeshta, të qarkullimit rrugor ose vizatimi i një plani të thjeshtë të shkollës apo të lagjes ku jeton).

LINJA IV. Historia dhe kultura

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përcaktojë rolin që luajnë përdorimi i vijave, modeleve etj., në artin lokal dhe kombëtar (p.sh: Diskutim - karakteristikat e kostumeve popullore kombëtare ose krahasimi i vazove të qeramikës nga krahina të ndryshme të vendit).
- Të përcaktojë e të diskutojë për ndikimin që luan mjedisi gjeografik në artin lokal apo kombëtar (p.sh: Vizitë në galerinë e arteve).
- Të përshkruajnë veshjen në periudha të ndryshme kohe (p.sh: Diskutim - veshja e një luftëtari, kostumet për ceremonitë e festave etj).

LINJA V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të krahasojë dhe të analizojë dy vepra arti që trajtojnë të njëjtën temë, të realizuara në periudha të ndryshme (p.sh: Diskutim - portreti i Mona Lizës nga Leonardo da Vinçi dhe “Motra Tone” nga Idromeno).
- Të përcaktojë ndryshimet dhe ngjashmëritë në punime të ndryshme të artit (p.sh: Diskutime - për piktura, skulptura, punë artizanale etj).

LINJA VI. Lidhja me jetën dhe mjedisin

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të diskutojë për përdorimin e kontrastit në zbukurimin e mjediseve, (p. sh., nëpër reklama).
- Të përcaktojë dhe të përshkruajë rolin e përdorimit të vijave, ngjyrave, përmasave për të tërhequr vëmendjen në një zbukurim, në një veshje, paketim etj. (*Krijim - album fotografik me njerëzit e familjes (krahasimi i fotove në periudha të ndryshme*).
- Të përcaktojë ndikimin gjeografik në arkitekturën e një vendi (p.sh: *Diskutim pas një vizite në një galeri ose muze*).

KLASA V - të

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

$$30 \text{ javë} \times 1 \text{ orë} = 30 \text{ orë}$$

1. Baza materiale, procese e teknika	2 orë
2. Elemente dhe parime	13 orë
3. Tematika	4 orë
4. Histori dhe kulturë	4 orë
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	4 orë

LINJA I. Baza materiale, procese, teknika

2 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të dallojë vepra arti të periudhave të ndryshme historike, duke kuptuar dhe u bazuar në *mjetet dhe teknikat e përdorura* për krijimin e tyre si: pikturat e shpellave, skulpturën në gur, mermer etj, enët e qeramikës, pikturat murale, pikturat në papirus etj. (bisedë e ilustruar me libra ose foto të gjetura në internet)
- Të përdorë mjetet: laps, vizore, penë (apo në kompjuter) duke realizuar një *shkrim me një stil* të caktuar. (Punë përgatitore mbledhja e disa stileve të shkrimit nga revistat, gazetatat etj).
- Të përzgjedhë *mjetet dhe materialet* për të ilustruar një ngjarje personale. (Punim 2 përmasor, p.sh. kolazh).

LINJA II. Elemente dhe parime

13 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përdorë *vijat* për të krijuar perspektivën me një pikë ikje. (Shinat e trenit)
- Të përdorë *lloje të ndryshme formash (figurat)* për të krijuar imazhe vizuale. (Pejsazh ose natyrë e qetë, duke e realizuar me lapustilë)
- Të përdorë *formën tre përmasore* për të krijuar objekte funksionale. (Krijon forma funksionale në rolin e një artist dizajni si: enë kuzhine, mobilie, makinë etj. – plastelinë, baltë etj.)
- Të krijojë *sipërfaqen* nga përdorimi i materialeve të ndryshme.
- Të përdorë tre materiale të ndryshme për të krijuar një punë 2 ose 3 përmasore, dhe të përcaktojë ndryshimin e sipërfaqeve). (Instalacion me tre materiale të ndryshme).
- Të përdorë *kontraste të ndryshme ngjyrash*, për të krijuar një gjendje emocionale. (Përdorimi i tonaliteteve të përafërta me kontraste të buta, tregon një gjendje qetësie, ndërsa kontrastet e forta të ngjyrave parësore dhe dytësore krijojnë një gjendje hareje).
- Të përdorë *hapësirën* për të identifikuar *qendrën e interesit* ose *pikën e theksit*. (Përdorimi i perspektivës me dy pika ikje, konceptim i thjeshtë për të dhënë idenë e tre përmasores në krijimin 2 përmasor). (Qyteti nënujor)
- Të përdorë *baraspeshën simetrike ose asimetrike* për të krijuar një poster për ndonjë aktivitet shkollor. (Tema mund të merret nga lënda e Edukatës shoqërore).
- Të përdorë *masën, ngjyrën, formën* për të krijuar *qendrën e interesit*. (Dekoracion duke përdorur masën, ngjyrat, formën).
- Të krijojë një punë ku jepet ideja e lëvizjes, duke përsëritur elementët e *vijave, ngjyrave dhe formave*. (Ditëlindja ime)
- Të krijojë përmes elementit të *unitetit*, duke përsëritur elementët. (Ky objektiv mund të realizohet në një temë mësimore me atë të lëvizjes).
- Të krijojë *kontrastin* në krijim, duke përdorur një nga elementet: *vijen, formën, ose ngjyrën* për të tërhequr vëmendjen e shikuesit. (Një njoftim ose reklamë etj.)

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përzgjedhë *bazën materiale dhe teknikën e duhur*, si dhe *elementet e parimet e artit* në shërbim të përmbajtjes. (Krijimi i një albumi familjar, ku nxënës dekoron pjesën e kapakut).
- Të diskutojë *figurat simbolike* të një seti letrash – lojë dhe ti krijojë ato në grup. (Lojë (letra bixhozi - punë në grup) .

LINJA IV. Historia dhe kultura

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të kuptojë që *flora, fauna, ngjyrat e natyrës* ndikojnë në krijimtarinë artistike të artistëve të një vendi. Njohja me kulturën popullore shqiptare si: *dekoracionet, veshjet, objektet artistike* etj. (Kopjim i një motivi popullor).
- Të përmendë artistë të artit figurativ shqiptar dhe të përshkruajë veprimtarinë e tyre artistike si: (V. Miho, A. Buza etj).
- Të përshkruajë dhe të shpjegojë ndikimin e materialeve në krijimin e një arti të veçantë: arti i sixhadeve.

LINJA V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të shpjegojë përdorimin e *kontrastit, theksit dhe perspektivës* në vepra të ndryshme arti ose në punën e tij dhe të shokut.
- Të bashkëpunojë në krijimin e një ekspozite punimesh në shkollë. (Bisedë me një kurator në një ekspozitë, në një shkollë apo në një galeri arti).

LINJA VI. Lidhja me jetën dhe mjedisin

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të komentojë marrëdhëniet e artit në jetën e përditshme si: dekorimi i mjedisve familjare apo në klasë, në raste festash. (Zbukurimi i klasës me rastin e Vitit të Ri, 7 - 8 Marsit).

- Të përshkruajë arkitekturën e qendrës së banimit, si është dhe si mund të ishte ndryshe. (Krijim me objekte 3 përmasore, duke përdorur trupa gjeometrikë të gatshëm).
- Të kuptojë artin e mobilimit të shtëpisë. (Krijim-moket me karton e një hapësire të brendshme).